

Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në jetën shoqërore në Mal të Zi



Ministria drejtësisë,
njërëzore unë minoriteti
të drejtat



GRAĐANSKA
ALIJANSA

Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në jetën shoqërore në Mal të Zi

Emri publikimit

Përfaqësimi i femrave nga popujt
pakicë në jetën shoqërore në Mal të Zi

Për botuesin



Autorët

Milan Radoviq, Amina Muriq, Zoran Vujićiq,
Pavle Čupiq, Milica Stankiq

Dizajni dhe shtypi

APprint

Tirazhi

100 kopje

Viti dhe vendi i botimit

prill 2022, Podgoricë

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе,
Цетиње

ISBN 978-9940-741-19-8
COBISS.CG-ID 22069764

PËRMBAJTJA

I	HYRJE.....	5
II	PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PUSHTETIN LEGJISLATIV NË MAL TË ZI	7
a)	Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë ndër deputetet e Kuvendit të Malit të Zi.....	7
b)	Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në administratën e Kuvendit të Malit të Zi në pozitat më të spikatura.....	9
III	PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PUSHTETIN EKZEKUTIV NË MALI TË ZI	11
a)	Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozitat ministrore.....	11
b)	Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozitat e larta të administratës së Qeverisë së 42-të të Malit të Zi	12
IV	PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PUSHTETIN GJYQËSOR TË MALIT TË ZI	15
V	PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PARLAMENTET LOKALE DHE ADMINISTRATAT KOMUNALE NË MALIN E ZI	17
VI	PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	20
	Aneks 1.....	22
	Aneks 2.....	24
	Aneks 3.....	25
	Aneks 4.....	27

I HYRJE

Me kënaqësi prezantojmë publikimin e gjashtë të edicionit të Aleancës Qytetare me rastin e Ditës së Pavarësisë.

Kjo analizë është pjesë e projektit “Për pozitën më të mirë të femrave nga komunitetet pakicë në sistemin e Malit të Zi”, i financuar nga Ministria e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave.

Në analizën që hartuam u dha një pasqyrë e besueshme e përfaqësimit të pjesëtareve të popujve pakicë në Malin e Zi në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe në nivelin lokal .

Në pjesën e parë të analizës pasqyrojmë përfaqësimin e femrave nga popujt pakicë në pushtetin legjislativ në Malin e Zi. Analiza mbulon periudhën nga ripërtëritja e pavarësisë së Malit të Zi deri më 31 Mars të këtij viti. Prezantuam të dhënat për femrat nga popujt pakicë të cilat në periudhën e cekur kanë mbuluar funksionin e deputetes, përfaqësimin e tyre në pozitat e kryetareve dhe nënkryetareve të Kuvendit të Malit të Zi, si dhe në pozitat e kryetareve të trupave të Kuvendit. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar administratës së Kuvendit dhe përfaqësimit të pjesëtareve të popujve pakicë në vendet e Sekretares së përgjithshme dhe zëvendësës së saj, përfshirë pozitën e Sekretares së trupave punues në Kuvendin e Malit të Zi.

Pjesa e dytë e analizës i kushtohet përfaqësimit të femrave nga popujt pakicë në pushtetin ekzekutiv. Në kontekstin e posteve ministrore, u mbulua periudha nga ripërtëritja e pavarësisë së Malit të Zi deri më 31 Mars të këtij viti. Kur marrim parasysh njerëzit që punojnë në administratë, në pozita të larta në Qeverinë e Malit të Zi, për shkak të mungesës së të dhënave në faqen zyrtare, përpunuam vetëm ato të dhëna që kanë të bëjnë me Qeverinë aktuale të Malit të Zi. Një pjesë e analizës i kushtohet përfaqësimit të femrave nga popujt pakicë në pozitat e larta në Sekretariatit e përgjithshëm të Qeverisë, si dhe në ministri në pozitat e Sekretares së përgjithshme dhe Drejtores së drejtorisë. Përveç këtyre, janë

përpunuar të dhënat që kanë të bëjnë me bartësit e funksioneve më të larta në drejtoritë, entet dhe agjencitë qeveritare.

Me qëllim të qasjes së informatave nga periudha e mëhershme, mendojmë që Qeveria e Malit të Zi, ngjashëm si Kuvendi, duhet t'i vë në dispozicion të dhënat për qeveritë e kaluara dhe anëtarët e administratave të tyre, të paktën nga ripërtëritja e pavarësisë së Malit të Zi..

Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pushtetin gjyqësor u trajtua në pjesën e tretë të kësaj analize. Të dhënat e paraqitura në këtë analizë i referohen situatës në muajin mars të vitit 2022 dhe janë marrë nga faqja e internetit www.sudovi.me. Përpunimi i të dhënave përfshiu personat që aktualisht mbulojnë funksione në gjyqësor, ata që janë në krye të gjykatave, si dhe Këshillin Gjyqësor. Gjatë mbledhjes të dhënave kemi vërejtur se disa gjykata nuk i përditësojnë rregullisht të dhënat në ueb faqet e tyre.

Pjesa e katërt e analizës i kushtohet përfaqësimit të femrave nga popujt pakicë në pozitat e larta në pushtetin lokal. Të dhënat e përpunuara i referohen përbërjeve aktuale të parlamenteve lokale dhe pozitave më të larta në pushtetin ekzekutiv në nivel lokal dhe në administratën lokale.

Pjesë e veçantë e kësaj analize ka të bëjë me përfundimet dhe rekomandimet ku sugjeruam në cilën mënyrë mund të arrihet përfaqësimi më i madh i femrave, njëdhimisht edhe i femrave nga popujt pakicë në pozitat përgjegjëse në Malin e Zi.

Gjatë përpilimit të analizës përdorëm të dhënat e disponueshme në faqet zyrtare të internetit të Parlamentit të Malit të Zi, Qeverisë së Malit të Zi, komunave, faqes zyrtare që përmban informacione për gjykatat. Për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hartimin e kësaj analize, ne iu drejtuam të gjitha komunave me kërkesë për qasje të lirë në informata. Për shkak të mosrespektimit të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata nga përfaqësuesit e disa komunave, u privuam nga një sërë të dhënash që do të jepnin pasqyrë më të plotë për temën që përpunojmë.

Anekset, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj analize, përmbajnë informacione më të detajuara për femrat të cilat gjatë periudhave të caktuara mbulonin pozita të larta në Malin e Zi.

II PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PUSHTETIN LEGJISLATIV NË MALIN E ZI

Kjo pjesë e analizës ka të bëjë me përfaqësimin e femrave nga popujt pakicë në Kuvendin e Malit të Zi, si ndër ato që mbulojnë funksionin e deputetes, ashtu edhe ndër ato që punojnë në administratën e Kuvendit në pozitat më të larta.

Kur bëhet fjalë për femrat nga popujt pakicë në funksionet e deputeteve, u analizua perioda nga ripërtëritja e pavarësisë së Malit të Zi e deri më sot, duke përfshirë kështu pesë përbërje të Kuvendit.

Gjatë analizës së përfaqësimit të femrave nga popujt pakicë në administratën e Kuvendit, në vendet më të spikatura, janë shfrytëzuar të dhënat e disponueshme në faqen zyrtare të Kuvendit të Malit të Zi.


a) Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë ndër deputetet e Kuvendit të Malit të Zi

Nga përbërja e 23-të deri në të 27-ën të Kuvendit të Malit të Zi në bankat e deputetëve u ulen gjithsej 62 deputete, disa prej të cilave kanë kryer funksionin gjatë gjithë mandatit, kurse disa u larguan nga funksioni i deputetes gjatë mandatit të tyre. Vetëm tetë deputete në Parlamentin e Malit të Zi vinin nga popujt pakicë. Lista e të gjitha deputeteve në Parlamentin e Malit të Zi në periudhën e analizuar është pasqyruar në Aneksin 1 të këtij raporti¹.

Grafiku që vijon tregon sa ishin të përfaqësuara femrat nga popujt pakicë në Kuvendin e Malit të Zi sipas përbërjeve.

1 Të dhënat janë marr nga faqja zyrtare e Kuvendit të Malit të Zi, në vegëzën <https://www.skupstina.me/>

**NUMRI I PJESËTAREVE TË POPUJVE PAKICË NË KUVENDIN E MALIT TË ZI
NË PERIUDHËN NGA VITI 2006 DERI NË VITIN 2022**




Grafiku 1: Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në Kuvendin e Malit të Zi sipas përbërjeve

Më së shumti femra nga popujt pakicë kishte në bankat parlamentare në përbërjen e 25-të të Kuvendit të Malit të Zi, kur pesë prej tyre kryenin funksionin e deputetes. Nga ripërtëritja e pavarësisë së Malit të Zi nuk u gjet asnjë grua në vendin e kryetares së Kuvendit të Malit të Zi. Në përbërjen aktuale, të 27-të, të Parlamentit të Malit të Zi, për herë të parë një femër mban postin e nënkryetares së Kuvendit të Malit të Zi, mirëpo ajo nuk është pjesëtare e popujve pakicë.

Numri i trupave punues të Kuvendit të Malit të Zi ka ndryshuar që nga viti 2006 deri më sot. Në krye të tyre në përbërjen e 23-të të Kuvendit të Malit të Zi ishte një grua, derisa në përbërjen e 27-të të Kuvendit të Malit të Zi katër trupa punuese drejtohen nga femrat, prej të cilave asnjëra nuk është pjesëtare e popujve pakicë.

PËRFAQËSUESET E POPUJVE PAKICË NË VENDIN E KRYETARES SË TRUPAVE PUNUESE TË KUVENDIT TË MALIT TË ZI NË PERIUdhËN nga VITI 2006 DERI NË VITIN 2022



Grafiku 2: Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozicionet e kryetares së trupave punuese në Kuvendin e Malit të Zi


b) Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në administratën e Kuvendit të Malit të Zi në pozicionet më të spikatura

Duhet theksuar se në pozitën e Sekretares së përgjithshme të Kuvendit të Malit të Zi asnjëherë nuk ishte një grua, si rrjedhojë nuk kishte as përfaqësuese të popujve pakicë. Në periudhën nga viti 2006, deri më sot, asnjë përfaqësuese e popujve pakicë nuk ka mbuluar pozitën e zëvendës Sekretares së përgjithshme të Kuvendit të Malit të Zi.

Numri i trupave punues të Kuvendit ka ndryshuar nga viti 2006 e deri më sot, por përfaqësimi i dobët i pjesëtarëve të popujve pakicë në pozitën e sekretareve të trupave punuese mbetet konstant. Sipas të dhënave që janë në dispozicion, vetëm një përfaqësuese e popujve pakicë ishte në pozicionin e sekretarit të një trupi punues².

Në vazhdim është dhënë tabela e përfaqësimit të pjesëtareve të popujve pakicë në pozitat e sekretarit/eve të trupave punues në Kuvendin e Malit të Zi.

PËRFAQËSUESET E POPUJVE PAKICË NË POZITAT E SEKRETAREVE TË TRUPAVE PUNUESE TË KUVENDIT TË MALIT TË ZI



Grafiku 3: Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozitat e sekretareve të trupave punuese në Kuvendin e Malit të Zi


III PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PUSHTETIN EKZEKUTIV NË MALIN E ZI

Në periudhën nga ripërtëritja e pavarësisë shtetërore të Malit të Zi në vitin 2006 e deri më sot janë formuar gjashtë Qeveri të Malit të Zi. Numri i anëtarëve të Qeverisë ka ndryshuar në periudha të ndryshme dhe më e shumta ishte Qeveria e 41-të e Malit të Zi, e cila kishte kryetarin dhe 20 anëtarë kur u votua në Kuvendin e Malit të Zi.

Në vazhdim të kësaj pjese të analizës do të paraqesim të dhënat për përfaqësimin e pjesëtareve të popujve pakicë në pozitat ministrore nga Qeveria e 37-të e Malit të Zi deri në të 42-tën.

a) Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozitat ministrore

Në vazhdim është grafiku me numrin e anëtarëve të Qeverisë në periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2022.




Grafiku 4: Numri i anëtarëve të Qeverisë së Malit të Zi sipas përbërjeve

Përfaqësimi i femrave në Qeverinë e Malit të Zi ka ndryshuar në periudhën e analizuar. Vetëm nga një grua ishte anëtare e Qeverisë së 37-të, 38-të dhe 39-të të Malit të Zi

pas ripërtëritjes së pavarësisë, kurse në Qeverinë e 40-ë, 41-të dhe 42-të të Malit të Zi ishin nga katër përfaqësues.

Në periudhën e analizuar, ndër anëtarët e Qeverisë së Malit të Zi ishte edhe anëtarja nga radhët e popujve pakicë në Malin e Zi. Përkatësisht në Qeverinë e 40-të dhe 41-të të Malit të Zi në postin e ministres pa portofol ishte përfaqësuesja e popujve pakicë.

ANËTARET E QEVERISË SË MALIT TË ZI NË PERIUDHËN NGA VITI 2006 DERI NË VITIN 2022



Grafiku 5: Numri i anëtareve të Qeverisë së Malit të Zi sipas përbërjeve


Regjistri i të gjitha femrave që kanë kryer funksionin ministror në Qeverinë e Malit të Zi gjatë periudhës së analizuar është paraqitur në Aneksin 2 të kësaj analize.

b) Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozitat e larta në administratën e Qeverisë së 42-të të Malit të Zi

Të dhënat rreth përbërjes së kabinetit të kryetarit dhe nënkryetarit të Qeverisë së Malit të Zi, si dhe të ministrive dhe Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Malit të Zi kanë të bëjnë vetëm me Qeverinë e 42-të të Malit të Zi, sepse informatat nga periudha mëparshme nuk janë në dispozicion ose nuk ishte e mundur të gjenden në faqen e internetit të Qeverisë së Malit të Zi.

Në vazhdim është grafiku me numrin e anëtareve të popujve pakicë në pozitat e larta në administratën e Qeverisë së Malit të Zi.

PËRFAQËSIMI NË POZITAT E LARTA NË ADMINISTRATËN E 42-TË TË QEVERISË SË MALIT TË ZI



Grafiku 6: Numri i femrave në pozitat e larta të Qeverisë së 42-të të Malit të Zi

Duke analizuar të dhënat e publikuara, gjetëm se në pozitat e larta në Qeverinë e Malit të Zi³ ka 45 meshkuj dhe 40 femra, ndër të cilat vetëm katër janë nga radhët e popujve pakicë⁴.

Lista e plotë e femrave që mbulojnë pozitat e larta në kabinetet e kryetarit dhe nënkryetarit të Qeverisë së Malit të Zi, si dhe në ministri gjendet në Aneksin 3 të kësaj analize.

Pjesë e analizës janë edhe të dhënat për personat që mbulojnë pozitat udhëheqëse në 25 drejtori, ente dhe agjenci. Sipas të dhënave të disponueshme, në pozitat udhëheqëse janë shtatë femra, ndër të cilat asnjëra s'i përket popujve pakicë në Malin e Zi.

Lista e plotë të personave që gjenden në pozitat udhëheqëse të drejtorive, enteve dhe agjencive gjendet në Aneksin 4 të kësaj analize.

3 Bëhet fjalë për sekretarët shtetëror, drejtorët e drejtorive, drejtorëve të përgjithshëm, shefat e kabinetit, këshilltarët në kabinetin e kryetarit dhe nënkryetarit të Qeverisë së Malit të Zi.

4 Të gjitha të dhënat janë marr nga faqja zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi Lart në vegëzën: <https://www.gov.me/organizaciona-struktura>

Në vazhdim është dhënë grafiku i strukturës udhëheqëse në drejtori, ente dhe agjenci.



Grafiku 7: Përfaqësimi i femrave nga popujt pakicë në pozitat udhëheqëse në drejtori, ente dhe agjenci

IV PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NGA POPUJT PAKICË NË PUSHTETIN GJYQËSOR TË MALIT TË ZI


Kjo pjesë e analizës do të diskutojë përfaqësimin e femrave nga popujt pakicë në pozitat e gjyqësorit në Mal të Zi, pastaj në pozitat e kryetarëve të gjykatave, si dhe përfaqësimin në Këshillin Gjyqësor.

Duke analizuar të dhënat nga vendimet për numrin e gjyqtarëve në gjykata, arritëm në përfundimin se në Mal të Zi janë 322 pozita për gjyqtarë në të gjitha gjykatat⁵. Në momentin e shkrimit, jo të gjitha vendet vakante janë plotësuar.

Me përpunimin e të dhënave të disponueshme publikisht, u konstatua se funksionet gjyqësore në të gjitha gjykatat në Mal të Zi kryhen nga gjithsej 11 anëtarë të popujve pakicë në Mal të Zi⁶. Gjithashtu, u konstatua se asnjë përfaqësues nga popujt pakicë në Mal të Zi nuk mbulon pozitën e kryetarit të ndonjë gjykate.

Në vijim është një paraqitje grafike e përfaqësimit të anëtarëve popujve pakicë në pozitat gjyqësore.

PPËRFAQËSIMI I GRAVE NGA POPUJT PAKICË NË POZICIONET E GJYKATËSEVE



Grafik 8: Përfaqësimi i grave nga popujt pakica në funksionet gjyqësore

5 Të dhënat janë mbledhur duke analizuar vendimet për numrin e gjyqtarëve në gjykata të marra nga Këshilli Gjyqësor, të cilat janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi.

6 Të dhënat janë mbledhur nga faqja <https://sudovi.me>

Kur flasim për përfaqësimin e grave në gjyqësorin në Mal të Zi, shohim se nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në Mal të Zi, funksionin në gjyqësor e ushtrojnë 151 gjyqtarë, prej të cilave vetëm 11 janë anëtarë të popujve pakicë në Mal të Zi.

Në vijim është një paraqitje grafike e përfaqësimit të grave në gjyqësorin në Mal të Zi.



Grafik 9: Përfaqësimi i grave në gjyqësorë në Mal të Zi

Analizom javno dostupnih podataka, utvrđeno je da se među predsjednicama sudova ne nalazi niti jedna žena iz reda manje brojnih naroda u Crnoj Gori.

Sudski savjet ima predsjednika i devet članova, od čega je predsjednik Vrhovnog suda jedan član, četiri mjesta su rezervisana za sudije koje bira i razrješava Konferencija sudova, četiri člana dolaze iz reda uglednih pravnika, a član Sudskog savjeta je i ministar nadležan za poslove pravosuđa⁷.

Trenutno Sudski savjet čine tri člana koji dolaze iz reda uglednih pravnika, v.d. predsjednica Vrhovnog suda Crne Gore, dva člana koja dolaze iz reda sudija, kao i predsjednik Vlade Crne Gore koji je u ovom trenutku koordinator ministarstva pravde.

Nijedna članica Sudskog savjeta ne dolazi iz reda manje brojnih naroda u Crnoj Gori.

V PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NË KUVENDET DHE ADMINISTRATËN LOKALE NË MAL TË ZI

Barazia gjinore është parakusht i domosdoshëm për demokratizimin e shoqërisë sonë, kusht i rëndësishëm për të dëshmuar pjekurinë tonë në zbatimin e parimeve dhe vlerave evropiane.

Është e nevojshme të mundësohet përfshirja e qëndrueshme dhe cilësore e grave nga popujt pakicë në jetën politike, në proceset vendimmarrëse në Mal të Zi, veçanërisht duke pasur parasysh qëllimet strategjike të miratuara të Malit të Zi kur bëhet fjalë për barazinë gjinore në vendimmarrjen politike, përfshirë vlerësimet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë drejtim.

Në periudhën nga janari deri në mars të vitit 2022, Aleanca Qytetare monitoroi dhe analizoi përfaqësimin e grave që i përkasin popujve pakicë në nivel lokal. Në këtë drejtim, ne i dërguam kërkesën për qasje të lirë në informacion të gjitha pushteteve lokale në Mal të Zi⁸.


Nga gjithsej 25 kërkesa të dorëzuara, të dhënat na janë dorëzuar nga 23 komuna në Mal të Zi⁹.

Nëse vërejmë vendimmarrësit kryesorë në nivel lokal, arrijmë në përfundim se nga 25 kryetarë bashkie/kryetare bashkie, vetëm tre janë kryetare gra, nga të cilat një është anëtare e popullit pakicë. Më poshtë është një paraqitje grafike e përfaqësimit të anëtarëve të popujve pakicë në pozitat e kryetarit, si dhe përfaqësimi i grave në përgjithësi në pozitën e përmendur.

8 Ne kërkuam nga qeveritë lokale që të na ofrojnë këto të dhëna: numrin e grave të përfaqësuara në Kuvendin Komunal si këshilltare, numrin e grave nga popujt pakicë të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës si këshilltare dhe numrin e grave të punësuara në vetëqeverisjen lokale.

9 Këto janë komunat: Rozhaje, Tivar, Ulqin, Tivat, Cetinë, Kolashin, Andrijevicë, Mojkovac, Tuz, Shavnik, Petnjicë, Nikshiq, Zhabljak, Berane, Bijelo Polje, Pluzhine, Podgoricë, Golubovci, Plavë, Kotor. Tri komuna nuk kanë dorëzuar të dhëna, konkretisht: Danilovgrad, Guci dhe Herceg Novi.

PËRFAQËSUESET E POPUJVE PAKICË NË VENDIN E KRYETARES SË KOMUNËS NË MALIN E ZI




■ Kryetarë të komunës në Malin e Zi ■ Kryetare të komunës në Malin e Zi nga popujt pakicë ■ Kryetare të komunës në Malin e Zi nga popujt pakicë

Grafiku 10: Raporti i meshkujve dhe grave mes presidentëve të komunave në Mal të Zi

Më shpesh, një grua mund të gjendet në pozicionin e nënkryetares. Sa i përket nivelit lokal, mund të themi se pjesëmarrja e grave është më e lartë në përqindje krahasuar me nivelin shtetëror. Të dhënat që morëm nga 23 komuna tregojnë se 238 gra janë pjesë e parlamenteve vendore, që përfaqëson 31% të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve (754). Më poshtë është një paraqitje grafike e përfaqësimit të grave në parlamentet lokale, si dhe e anëtarëve të popujve pakicë.


NUMRI I KËSHILLTAREVE NGA POPUJT PAKICË



■ Numri i këshilltareve ■ Numri i këshilltareve përfaqësuese të popujve pakicë

Grafiku 11: Përfaqësimi i këshilltareve nga popujt pakicë në parlamentet lokale në raport me numrin e përgjithshëm të këshilltareve

Në pushtetet lokale në Mal të Zi përfaqësimi i grave në raport me burrat është shumë më i mirë. Grafiku i mëposhtëm tregon raportin mes grave dhe burrave në qeverisjen vendore në shtatë komuna, nga të cilat kemi marrë të dhëna për numrin total të të punësuarve dhe sa punonjës janë gra.



Grafiku 12: Përfaqësimi grave në vetëqeverisjet lokale në Mal të Zi

Siç shihet nga grafiku, i cili përfshin të dhëna nga shtatë komuna, përfshirë Podgoricën dhe Nikshiqin, si dy qytetet më të mëdha me shumicën e popullsisë, nga gjithsej 1776 punonjës të pushtetit vendor, 947 janë gra, që përfaqësojnë 53%. Pjesëmarrja e grave në numrin total të të punësuarve është në mënyrë drastike më e lartë se në rastin e pozitave drejtuese, gjë që tregon se me uljen e përgjegjësisë rritet përqindja e pjesëmarrjes së grave.

VI PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Kushtetuta e Malit të Zi garanton barazinë midis grave dhe burrave. Megjithatë, gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në pozitat më të përgjegjshme dhe për këtë arsye nuk janë as gratë nga popujt pakicë. Të dhënat e paraqitura në këtë analizë konfirmojnë se gratë nga popujt pakicë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në nivelet më të larta të të tri degëve të pushtetit, përfshirë nivelin lokal. Në periudhën e ardhshme është e nevojshme të kryhen një sërë aktivitete në mënyrë që gratë nga popujt pakicë të marrin një vend në shoqëri që sigurisht e meritojnë.

Ne rekomandojmë aktivitetet e mëposhtme për të arritur qëllimin e përcaktuar:

- Përfaqësuesit e të gjitha degëve të qeverisë të bëjnë përpjekje shtesë për krijimin e kushteve për përfaqësim më të mirë të grave, veçanërisht të atyre nga popujt pakicë;
- Partitë politike të fillojnë të zbatojnë standardet tashmë të miratuara në praktikë dhe të luftojnë kundër diskriminimit ndaj grave, veçanërisht atyre që vijnë nga popujt pakicë;
- Klubi i Grave, i themeluar si organ pune joformalë i Kuvendit të Malit të Zi, në përputhje me qëllimet për të cilat është formuar, në bashkëpunim me Komisionin për Barazi Gjinore të Kuvendit të Malit të Zi, të punojë për sensibilizimin e të gjithë qytetarëve dhe grave nga popujt pakicë përmes organizimit të një sërë seminaresh / tryezash të rrumbullakëta në të gjitha komunat në Mal të Zi.
- Gratë dhe anëtarët e popujve pakicë në pozita të larta në të gjitha degët e pushtetit, në nivel shtetëror dhe lokal, të inkurajojnë përmes paraqitjeve publike gratë tjera të përfshihen më aktivisht në proceset në Mal të Zi. T'i inkurajojë ata të aplikojnë për çdo pozicion për të cilin kërkohet një person i kompetencës së tyre. Përfaqësuesit e partive politike nëpërmjet organeve të partive të tyre të ndikojnë në përfaqësimin më të mirë të grave

dhe anëtarëve të popujve pakicë në organizatat e tyre politike, në pozitë ku merren vendime.

Aneks 1

Lista e të gjithë deputetëve në Parlamentin e Malit të Zi në periudhën 2006-2022

KUVENDI I MALIT TË ZI 2006-2022	
R.b.	Emri dhe mbiemri
1	Valentina Radulloviq Shqepanovi
2	Njegosava Vujanovi
3	Gordana Gjurovi
4	Branka Tanasijeviq
5	Ljubica - Beba Xhakovi
6	Hidajeta Bajramspahi
7	Marija Qatovi
8	Jovanka Matkovi
9	Maja Kostiq Mandiq
10	Branka Boshnjak
11	Maida Beshliq
12	Nada Drobnjak
13	Ljubica Aranitovi
14	Snezhana Jonica
15	Natasha Vukovi
16	Veselinka Pekovi
17	Dushanka Xhakulla Tushup
18	Daliborka Pejovi
19	Zorica Kovaçeviq
20	Sanja Vlahovi
21	Marta Shqepanovi
22	Mubera Kurpejovi
23	Milica Pejanovi Gjurihi
24	Zhana Filipovi
25	Ljiljana Gjurihi
26	Jelisava Kalezi
27	Zdenka Popovi
28	Danijela Danka Markovi
29	Azra Jasavi

30	Zorica Martinoviq
31	Ana Ponosh
32	Ljerka Dragiçeviq
33	Nada Nenezic
34	Jovanka Laliçiq
35	Ana Nikoliq
36	Maja Bakrač
37	Suzana Pribiloviq
38	Aleksandra Vukoviq
39	Sanja Paviqeviq
40	Nela Savkoviq Vukçeviq
41	Zheljka Savkoviq
42	Vera Bulatoviq
43	Aleksandra Vujiçiq
44	Marina Joçiq
45	Anka Vukiçeviq
46	Danijela Paviqeviq
47	Valentina Miniq
48	Bozhena Jellushiq
49	Danijela Gjurovici
50	Dragica Sekulic
51	Draginja Vuksanoviq Stankoviq
52	Jelena Bozhoviq
53	Jovanka Bogavac
54	Kenana Strujiq Harbiq
55	Lidija Kljajic
56	Maja Vukiqeviq
57	Milosava Paunoviq
58	Natasha Jevriq
59	Simonida Kordic
60	Suada Zoronjiq
61	Tamara Vujoviq
62	Vesna Paviqeviq

Aneks 2

Lista e të gjitha grave që në një periudhë kanë mbajtur poste ministrore në Qeverinë e Malit të Zi që nga rivendosja e pavarësisë deri në Qeverinë e 42-të të Malit të Zi.

ANËTARET E QEVERISË SË MALIT TË ZI NË PERIUDHË PREJ 2006 DERI ME 2022.	
R.b.	Emri dhe mbiemri
1	Olivera Injac
2	Tamara Srzentiq
3	Vesna Bratiq
4	Jelena Boroviniq - Bojoviq
5	Marija Vuçinoviq
6	Dragica Sekuliq
7	Suzana Pribiloviq
8	Sanja Damjanoviq
9	Milica Pejanoviq – Gjurishiq
10	Sanja Vlahoviq
11	Zorica Kovaçeviq
12	Gordana Gjurovici

Aneks 3

Lista e grave në poste të larta në administratën e Qeverisë së 42-të të Malit të Zi.

GRATË NË POZITAT E LARTA NË ADMINISTRATËN E QEVERISË SË 42. TË MALIT TË ZI		
R.b.	Emri dhe mbiemri	Funksioni
1	Ivana Malloviq	Shefja e Kabinetit të Kryeministrit
2	Maida Gorçeviq	Këshilltare e Kryeministrit për pakica
3	Ana Samarxhiq	Këshilltare e Kryeministrit për urbanizëm
4	Svetlana Vukçeviq	Këshilltare e Kryeministrit për urbanizëm
5	Ana Rashoviq	Këshilltare e zëvendës Kryeministrit për organizim të brendshëm dhe politikë kadrovike
6	Snezhana Shhqepanoviq	Këshilltare e Sekretarit Gjeneral të Qeverisë
7	Allmedina Vukiq	v.d. pomoćnica generalnog sekretara Vlade - rukovoditeljka Sektora za koordinaciju, praćenje usklađenosti i praćenje sprovođenja strategija kojima se utvrđuju javne politike
8	Nada Vojvodiq	Ushtruese e detyrës e Ndhmës Sekretarit tëi Përgjithshëm i Qeverisë - Udhëheqës i Sektorit për Koordinimin, Monitorimin e Përputhshmërisë dhe Monitorimin e Zbatimit të Strategjive për Përcaktimin e Politikave Publike
9	Zorica Kordiq	Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë - Shef i Sektorit për Informim Publik mbi Bashkimin Evropian dhe procesin e anëtarësimit në BE
10	Irena Boshkoviq	Glavna pregovaračica
11	Dragana Markoviq	Zëvendës Kryenegociatori për negociatat për anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian
12	Tamara Brajoviq	Drejtor i Përgjithshëm Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Natyrës
13	Marina Izgarevici	Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë për Projektet dhe Sistemet e Informacionit
14	Radmilla Lainoviq	Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Legalizimit të Banesave
15	Milena Lipovina-Bozhoviq	Sekretari i Shtetit për Zhvillimin e Politikave Ekonomike
16	Ivana Gjurovici	Sekretarja e shtetit për turizëm
17	Jelena Jankoviq	Ushtruese e detyrës – Drejtoresh e Drejtorisë për Bashkëpunim Tregtar dhe Marrëdhënie Ekonomike me Jashtë
18	Renata Milutinoviq	Ushtruese e detyrës - Drejtoresh e Drejtorisë për Zhvillim Industrial dhe Rajonal

19	Marijeta Barjaktarović-Lanzardi	Ushtruese e detyres - Drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi Digjitale dhe Zhvillim Teknologjik
20	Aleksandra Gardashevq-Slavuljica	Ushtruese e detyres – Drejtoresh e Drejtorisë për Politikat Zhvillimore në Turizëm
21	Jasna Vujović	Ushtruese e detyres -. Drejtoresh e Drejtorisë për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë
22	Olivera Vukajlović	Ushtruese e detyrës - Drejtoresh e Drejtorisë për Përmirësimin e Konkurrueshmërisë
23	Majda Terzić	Ushtruese e detyres - Sekretar i Ministrisë së Financave dhe Mirëqenies Sociale
24	Biljana Vučetić	Koordinator e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
25	Marija Hajduković	Ushtruese e detyres – Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik në Administratën Publike, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projektet IPA
26	Danijella Nedeljković-Vukčević	Ushtruese e detyres – Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë për Rregullimin Normativ të Sistemit të Administratës Publike dhe Harmonizimin e Rregulloreve
27	Milijana Vukotić-Jellushiq	Ushtruese e detyres – Drejtoresh e Drejtorisë së Përgjithshme për Zbatimin Efektiv të Administratës së Mirë Publike
28	Milena Zhizhić	Sekretare e Ministrit për investime kapitale
29	Nikolina Mishnić	Sekretare Shtetërore e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave
30	mr Katarina Burzanović	Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë së Peshkimit
31	Andrijana Rakočević	Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë për Zhvillim Rural
32	Andrijana Medojević	Ushtruese e detyres - Sekretare e Ministrisë së Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave
33	Milica Kadović	Sekretare Shtetërore e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit
34	Slavica Ilinčić	v.d. generalne direktorice Direktorata za predškolsko vaspitanje, osnovnu školu i inkluzivno obrazovanje
35	Marija Lalatović	Ushtruese e detyres – Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë së Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm, Arsimit Profesional dhe Mësimit gjatë gjithë jetës
36	Neda Ojdanić	Ushtruese e detyres - Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Qendra ENIC/NARIC
37	Jelena Marash	Shefja e Shtabit të Ministrit të Brendshëm
38	Vesna Brajović	Sekretare e Ministrisë së Brendshme
39	Milica Perišić	Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Jashtme
40	Zdenka Radulović	Shefja e Protokollit Diplomatik të Ministrisë së Brendshme

Aneks 4

Lista e personave që mbajnë poste drejtuese në agjenci, institute, administrata dhe drejtori brenda Qeverisë së Malit të Zi.

RUKOVODIOCI VLADINIH AGENCIJA, ZAVODA, UPRAVA I DIREKCIJA		
R.b.	Ime prezime	Institucija
1	Millan Gazdiq	Agjencia për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit
2	Savo Vuçiniq	Direkcioni për mbrojtjen e të dhënave të fshehta
3	Danillo Mrvaleviq	Arkivi shtetnor i Malit të Zi
4	Boro Luçiç	Administrata e Punëve Publike
5	Zoran Brgjanin	Drejtorja e policisë
6	Milena Petriçeviq	Administrata e të hyrave dhe doganave
7	Vladimir Gjakoviç	Drejtorja për Siguri Ushqimore, Çështje Veterinare dhe Fitosanitare
8	Milan Tomiq	Drejtorja e Ekzekutimit të Sanksioneve Penale
9	Jovana Nišavić	Uprava za kadrove
10	Radomir Vuksanoviç	Drejtorja e Trafikut
11	Seid Haxhiq	Drejtorja për Bashkëpunim me Diasporë – Mërgimtarë
12	Marko Begoviç	Drejtorja për Sport dhe Rini
13	Miroslav Pejoviç	Drejtorja e Statistikave
14	Srgjan Pejoviç	Shërbimi Pyjor
15	Marko Axhiq	Drejtorja e Hidrokarbureve
16	Vesna Bajoviç	Drejtorja e ujërave
17	Mladen Zagarçanin	Drejtorja për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
18	Zhelimir Radinoviç	Drejtorja për hekurudha
19	Dushica Brnoviq	Byroa për hidrometeorologji dhe seizmologji
20	Gordana Bajiq	Byroa për meteorologji
21	Biljana Joksimoviç	Byroa për arsim
22	Drago Spaiq	Byroa për mbrojtje sociale dhe të fëmijëve në Mal të Zi
23	Ilir Harasani	Drejtorja për punë inspektoriale
24	Koça Gjurishiq	Drejtorja për kadaster dhe pronen e shtetit
25	Ivana Martiniq	Autoriteti i Sigurisë Detare dhe Menaxhimit të Portave

